



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 498/7 prot.,

Datë 03.03.2026

V E N D I M
Nr. 333/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar - Mallra”, me nr. REF-73483-12-30-2025, me objekt “Blerje Reagent dhe Epruveta”, me fond limit 1,400,000 (Një milion e katërqind mijë) lekë pa TVSH , zhvilluar më datë 12.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Kamëz sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK me Nipt L92207009A dhe adresë:, Rruga “Dibrës”, Kompleksi Arlis Farmacia, 10 shk.2 App. 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Kamëz Sh.a
Rruga “Paqësori”, Frutikulturë, Kamëz

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK me Nipt M51624039U dhe adresë: Bulevardi Shqiperia e Re, Pallatet Agimi, Shkalla 25, Ap. 399/2, Kati 4, Tiranë

Operatori ekonomik “Albuji” SHPK me Nipt: K64112206J dhe adresë Lagjja Hasan, Rruga "Bregut te Lumit", godinë një katëshe. nr.3, Fushë-Krujë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.12.2026, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar - Mallra”, me nr. REF-73483-12-30-2025, me objekt “Blerje Reagent dhe Epruveta”, me fond limit 1,400,000 (Një milion e katërqind mijë) lekë pa TVSH , zhvilluar më datë 12.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Kamëz sh.a..

II.2. Në datën 12.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 30.01.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ALBUJI” SHPK	1,049,000	lekë kualifikuar
2. “ALMedical” SHPK	846,800	lekë s’kualifikuar
3. “ECCAT Environmental Consulting, Chemical Analysis&Testing Shpk	1, 287,470	lekë kualifikuar
4. “ISOMETRIC” SHPK	1,050,020	lekë kualifikuar
5. “KEJ Group” SHPK	1,056,500	lekë kualifikuar
6. “KRIJON” SHPK	1,098,462	lekë kualifikuar
7. “Skyline SC” SHPK	969,000	lekë kualifikuar

II.4. Në datën 12.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6337 datë 17.02.2026 dhe me nr.498 prot., datë 17.02.2026 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertave së operatorëve ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

“.....Kompania ISOMETRIC shpk pasi ka shqyrtuar me rigorozitet vleresimin e AK mbi kualifikimin e te dy operatoreve, gjykon se kompanite ndodhen perballe faktit se jane te paafta te permbushin detyrimin e tyre ligjor ne lidhje me furnizimin me artikujt objekt prokurimi si dhe me kapacitetin e tyre teknik mbi trajnimin dhe kalibrimin e pajisjeve te autoritetit. Kete gje e konfirmojme pasi artikujt objekt prokurimi reagent/kite/pajisje matese jane ne 98% te tyre artikuj te firmes Hanna Instruments. Duke qene se per keto artikuj prokurimi kompania prodhuese Hanna i ka dhene oferte vetem kompanise sone ISOMETRIC (bashkangjitur deklarata nga prodhuesi), ku vertetohet qe kompania jone eshte e vetmja qe ka marre nje oferte te sakte nga prodhuesi i artikujve objekt prokurimi si dhe eshte e trajnuar mbi kalibrimin e pajisjeve te autoritetit me reagentet/kite/pajisje objekt prokurimi. Pra te dy operatoret e kualifikuar kane dhene nje oferte jo te bazuar ne cmime te verteta pasi nuk kane marre oferte nga prodhuesi per keto artikuj gje qe con ne pamundesine e tyre mbi furnizimin e autoritetit kontraktor me mallrat objekt prokurimi . Gjithashtu te dy operatoret ndodhen perballe pamundesise se tyre ne permbushjen e kerkeses nr. 4 ne dokumentacionin Specifikime dhe relacion teknik ku kerkohet :

4. Kriteret e pranueshmërisë

? Pajisjet duhet të jenë origjinale, të reja dhe të certifikuara (CE/ISO).

? Të kenë garanci minimale 12 muaj.

? Të dorëzohen me manual përdorimi dhe certifikata përputhshmërie.

? Furnizuesi të sigurojë instalim dhe trajnimin fillestar të personelit

Pasi nuk janë të certifikuar mbi instalimin, kalibrimin, trajnimin e pajisjeve objekt prokurimi nga kompania prodhuese.

Pra duke u ndodhur përballë këtyre fakteve kërkojmë nga Autoriteti kontraktor të skualifikojë të dy operatorët ekonomik Skyline SC dhe Albuji SHPK për shkak se kanë dhënë një ofertë jo të bazuar në çmime reale si dhe nuk kanë kapacitete teknike mbi instalimin, trajnimin dhe kalibrimin e pajisjeve objekt prokurimi si dhe të atyre që posedon autoriteti të firmës Hanna Instruments. (Bashkengjitur dokument provues nga firma prodhuese, deklarate zyrtare noterizuar.....”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.498/1 prot., datë 18.02.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatorët ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 23.02.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar me shkresën nr. 498/2 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar “Skyline SC” SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “Skyline SC” SHPK

II.8. Me shkresën nr.422, datë 24.02.2026, protokolluar me tonën nr. 498/3 prot., datë 25.02.2026, të ardhur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa me objek “Vendim i Komisionit të ngarkuar për shqyrtimin e ankesës dhe dhënien e vendimit lidhur me ankesën e operatorit ISOMETRIC për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-Mallra shpallur nga Autoriteti Kontraktor, Ujësjiellës kanalizime Kamëz Sh.a, me objekt “Blerje Reagent dhe Epruveta”, me numër REF-73483-12-30-2025, me fond limit 1,400,000 (Një milion e katërqind mijë) lekë pa tvsh, publikuar më datë 31.12.2025” mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e saj.

II.9 Me shkresën nr.422/1, datë 24.02.2026, protokolluar me tonën nr. 498/4 prot., datë 26.02.2026, është depozituar nëpërmjet shërbimit posta pranë Komisionit të Prokurimit Publik nga autoriteti kontraktor shkresa me objek “Vendim i Komisionit të shqyrtimit të ankesave.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK për s’ kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHPK me arsyetimin se *këta operatorë ekonomikë kanë dhënë një ofertë jo të bazuar në çmime reale si dhe nuk kanë kapacitete teknike mbi instalimin, trajnimin dhe kalibrimin e pajisjeve objekt prokurimi si dhe të atyre që posedon autoriteti të firmës Hanna Instruments....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën nr.1 “FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE”, të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon::

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: [Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i [Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE], përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.*
- (b) Ne [vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti], nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës [vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit].*
- (c) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor], në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për [vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar*

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

në SPE] në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

(e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.1.2. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumenteve të tenderit të modifikuara me shtojcën e datës 09.01.2026, të procedurës së prokurimit objekt – ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh

kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Lista e pajisjeve të kërkuara dhe përshkrimi teknik:

Nr.	Emertimi	Specifikime teknike	Paketimi	Sasia
1	Solucion Kalibrimi	Solucion standard laboratorik për kalibrimin e pajisjeve për matjen e konduktivitetit. Vlera nominale e konduktivitetit: (5.00 mS/cm)Për kalibrimin e matësve dhe testerëve të konduktivitetit për analiza laboratorike, ujë të pijshëm. shishe hermetikisht e mbyllur, e vulosur kundër manipulimit . Dokumentacion shoqërues: certifikatë analize, paketim minimal $\geq 225 \text{ mL}$	shishe	2
2	Buffer kalibrimi pH 1.0	për kalibrimin e pajisjes multiparametrike i gjurmueshëm sipas N.I.S.T., saktësi $\pm 0.02 \text{ pH}$ ose me e mire, Bazë ujore ($\geq 98 \% \text{ ujë}$) paketim jo me I vogël se 500 mL,shishe hermetikisht e mbyllur, e vulosur kundër manipulimit .	shishe	3

3	Buffer kalibrimi pH 13	për kalibrimin e pajisjes multiparametrike i gjurmueshëm sipas N.I.S.T., saktësi ± 0.05 pH ose më e mirë, Bazë ujore (≥ 99 % ujë) paketim jo me I vogël se 500 mL, shishe hermetikisht e mbyllur, e vulosur kundër manipulimit .	shishe	3
4	Solucion Kalibrimi Konduktiviteti me vlere 84 μ S/cm	Solucion standard kalibrimi EC 84 μ S/cm, NIST traceable, me tabelë temperature, për kalibrim të multiparametrave. Dokumentacion shoqërues: certifikatë analize, deklaratë konformiteti ose dokument teknik nga prodhuesi. paketim minimal ≥ 225 mL	shishe	3
5	Solucion Kalibrimi Konduktiviteti me vlere 1413 μ S/cm	Solucion standard kalibrimi EC 1413 μ S/cm, NIST traceable, me tabelë temperature, për kalibrim të multiparametrave. Dokumentacion shoqërues: certifikatë analize, deklaratë konformiteti ose dokument teknik nga prodhuesi. paketim minimal ≥ 225 mL	shishe	3
6	Solucion Kalibrimi Konduktiviteti me vlere 5000 μ S/cm	Solucion standard kalibrimi EC 5000 μ S/cm, NIST traceable, me tabelë temperature, për kalibrim të multiparametrave. Dokumentacion shoqërues: certifikatë analize, deklaratë konformiteti ose dokument teknik nga prodhuesi. paketim minimal ≥ 225 mL	shishe	4
7	Zero Oxygen Solution	I pershtatshem per kalibrimin e matesit DO , shishe 500ml.	shishe	4
8	Buffer kalibrimi pH 7.00	për kalibrimin e pajisjes multiparametrike i gjurmueshëm sipas N.I.S.T., saktësi ± 0.02 pH ose më e mire, paketim jo me I vogël se 500 mL, shishe hermetikisht e mbyllur, e vulosur kundër manipulimit .	shishe	4
9	Buffer kalibrimi pH 10.00	për kalibrimin e pajisjes multiparametrike i gjurmueshëm sipas N.I.S.T., saktësi ± 0.05 pH ose më e mire, paketim jo me I vogël se 500 mL, shishe hermetikisht e mbyllur, e vulosur kundër manipulimit .	shishe	4

10	Buffer kalibrimi pH 4.00	për kalibrimin e pajisjes multiparametrike i gjurmueshëm sipas N.I.S.T., saktësi ± 0.02 pH ose me e mire, paketim jo me I vogël se 500 mL, shishe hermetikisht e mbyllur, e vulosur kundër manipulimit .	shishe	4
11	Mates Konduktiviteti	0 .0 to 10000 μ S ; rezolucion:100 μ S. e shoqëruar me Sondë për matjen e përçueshmërisë (EC) , konektor DIN dhe kablllo rreth 1 m. kushte pune 0–50 °C, deri në 95% RH. i shoqëruar me solucion fillestar kalibrimi	cope	2
12	Standarte per kalibrimin e fotometrit te Klorit	0.01-10 mg/L Cl ₂ , teste 250. tableta individualisht të dozura, për lexim fotometrik në pajisje me gjatësi vale në zonën 520–530 nm	set	2
13	tableta per matjen e klorit te lire	Reagent për përcaktimin fotometrik të klorit të lirë (Free Chlorine) sipas metodës DPD No.1.Për fotometra DPD dhe për verifikim manual vizual, pa ndryshim metode.ë përputhje me ISO 7393-2 për ujë të pijshëm.I përshtatshëm për interval të ulët (Low Range) të klorit, me ndjeshmëri për vlera <1 mg/L.Pranohet vetem tablet jo pluhur	pako me 100 cope	20
14	Reagente per matjen e Ammonia HR	sipas metodës Nessler, diapazon te larte	300 teste	2
15	Reagente per matjen e Ammonia MR	sipas metodës Nessler, diapazon mesatar ~ 0-10mg/L (NH ₃ -N)	300 teste	2
16	Reagente per matjen e Ammonia LR	sipas metodës Nessler, diapazon te ulet 0-3mg/L (NH ₃ -N)	300 teste	2
17	Reagente per matjen e Calcium	Reagentë për matjen manuale të Kalciumit (Ca ²⁺) sipas metodës EDTA – titrim me pikatore 10 - 500 mg/l (CaCO ₃	kit	4
18	Reagente per matjen e Calcium dhe Magnesium	Reagentë për matjen manuale të fortësisë totale të ujit (Kalcium + Magnezium) sipas metodës EDTA me indikator Calmagite, në mg/L CaCO ₃	kit	4
19	Reagente per matjen e Magnesium	Reagent fotometrik selektiv për matjen e magnezit (Mg ²⁺) në ujë të pijshëm dhe ujë të trajtuar, me diapazon matjeje 0–100 mg/L, i bazuar në metodë kolorimetrike specifike për magnezin	50 teste	2

20	Reagente per matjen e Nitrate	Reagent fotometrik për matjen e nitrateve (NO_3^-) në ujë të pijshëm dhe ujë të trajtuar, diapazon 0–20 mg/L	100 teste	2
21	Reagente per matjen e Phosphate HR	Reagent fotometrik për matjen e fosfateve (PO_4^{3-}) në ujë të pijshëm dhe ujë të trajtuar, diapazon matjeje HR 0–100 mg/L PO_4 ,	100 teste	2
22	Reagente per matjen e Potassium	Reagent fotometrik selektiv për matjen e kaliumit (K^+) në ujë të pijshëm dhe ujë të trajtuar, diapazon matjeje 0–12 mg/L	100 teste	2
23	Reagente per matjen e Sulphate	Reagent fotometrik për matjen e sulfatave (SO_4^{2-}) në ujë të pijshëm dhe ujë të trajtuar, diapazon matjeje 0–200 mg/L,	100 teste	1
24	Tableta karboni aktiv	tablet karboni aktiv I pershtatshem per fotometer	50teste	3
25	Standarte :0nm,420nm,466nm,525nm ,610nm per fotometrin model HI83325	set me standarte "0nm,420nm,466nm,525nm,610nm per fotometrin"	set	1
26	Solucion pastrimi me baze alkooli per cuvetat	Solucion duhet të largojë mbetjet organike, yndyrat dhe ndotjet, të mos lërë mbetje, dhe të mos dëmtojë sipërfaqen optike të cuvetave.	230ml	1
27	AMCO-AEPA-1 Solucion kalibrimi ne 10FTU	Solucion kalibrimi turbidi tip AMCO-AEPA-1, vlerë 10 FTU (Zero turbidity),në përputhje me ISO 7027 dhe/ose EPA 180.1,shoqeruar me certifikate analize	30ml	1
28	AMCO-AEPA-1 Solucion kalibrimi ne 500FTU	Solucion kalibrimi turbidi tip AMCO-AEPA-1, vlerë 5000 FTU (Zero turbidity),në përputhje me ISO 7027 dhe/ose EPA 180.1,shoqeruar me certifikate analize	30ml	1
29	AMCO-AEPA-1 Solucion kalibrimi ne 0FTU	Solucion kalibrimi turbidi tip AMCO-AEPA-1, vlerë 0 FTU (Zero turbidity),në përputhje me ISO 7027 dhe/ose EPA 180.1,shoqeruar me certifikate analize	30ml	2
30	Solucion per heqjen e klorit	Flakon per perdorim me pika, 30ml	30ml	2

31	Standarte kalibrimi <0.1,15,100 dhe 750NTU perturbidimetrin model HI-98703 ose ekuivalent	Standarde kalibrimi për turbidi (NTU), Formazin ose polimer ekuivalent (AMCO-AEPA), vlera <0.1 NTU, rreth 15–20 NTU, rreth 100 NTU dhe rreth 750–800 NTU, në përputhje me ISO 7027 dhe/ose EPA 180.1, të pajisura me certifikatë analize	set	1
32	Mates per matjen e hekurit ne uje	diapazoni I matjes :0-5 mg/L me rezolucion 0.01 mg/L.Burimi i dritës të jetë LED me gjatësi vale të përshtatshme për analizat kolorimetrike, në zonën e dukshme të spektrit (rreth 525 nm).detektor drite të tipit qelizë fotovoltaike silikoni, të përshtatshme për matje të sakta kolorimetrike. Pajisja duhet të funksionojë në temperatura ambienti nga 0 deri në 50°C, me lagështi relative deri në 95% pa kondensim. Duhet të furnizohet me bateri standarde 1 × 1.5 V (AAA) dhe të disponojë funksion fikjeje automatike për kursim energjie, pas periudhe mos-përdorimi dhe pas përfundimit të matjes. Pajisja të jetë kompakte dhe e lehtë, e përshtatshme për përdorim portativ në terren dhe laborator.	cope	1
33	Reagente per matjen e hekurit ne uje per perdorim ne aparatin me siper	Reagent pluhur Për përdorim me një diapazon të pritur nga 0.00 deri në 5.00(mg/L) Sasia: 25 teste	25 teste	3
34	Kit testimi per amoniakun ne uje	sipas metodës Nessler, diapazon te ulet 0-3mg/L (NH3-N)	pako me 100 cope	3

4. Kriteret e pranueshmërisë

- Pajisjet duhet të jenë origjinale, të reja dhe të certifikuara (CE/ISO).
- Të kenë garanci minimale 12 muaj.
- Të dorëzohen me manual përdorimi dhe certifikata përputhshmërie.
- Furnizuesi të sigurojë instalim dhe trajnimin fillestar të personelit.

5.Përfundim

Pajisjet e specifikuara më sipër janë të domosdoshme për funksionimin e laboratorit të Ujësjetës Kanalizime Kamëz sh.a. Blerja e tyre do të garantojë matje të sakta, siguri në analiza dhe përmbushje të standardeve të kërkuara për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm dhe mbrojtjen e shëndetit publik.

III.1.3. Në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, A: DEKLARATË” Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës të Shtojcës 9 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuar të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

<i>Deklarata</i>	<i>Përgjigje</i>	
<i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.</i>	<i>Po [] Jo []</i>	

III.1.4. Në përmbushje të kriterëve më sipër operatori ekonomik “Skyline SC” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- oferta_reagent_kamez e cila përmban:

- Shtojca 1 “Formulari i ofertës ekonomike”, datë 12.01.2026 të nënshkruar dhe vulosur
- Shtojca nr. 3 “Lista e çmimeve të artikujvet”, datë 12.01.2026 të nënshkruar dhe vulosur.
- Deklarate_1 e cila përmban deklaratë origjine malli, datë 12.01.2026 deklaratë garancie, datë 12.01.2026 dhe deklaratë instalimi, datë 07.01.2026

- Skyline_vetdeklarim e cila përmban Shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ku në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, A: DEKLARATË” ka deklaruar si më poshtë:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje	
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [X] Jo []	

Ndërsa operatori ekonomik “Albuki” SHPK në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin si më poshtë:

- Oferta_Ekonomike_kamez e cila përmban Shtojcën nr.1 “Formulari i ofertës ekonomike”, datë 12.01.2026 të nënshkruar dhe vulosur
- Lista_e_cmimeve_kamez e cila përmban Shtojcën nr.3 “Lista e çmimeve të artikujvet”, datë 12.01.2026 të nënshkruar dhe vulosur
- Deklarata_Kamez e cila përmban Shtojcën 9 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit” ku në seksionin “Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimi, A: DEKLARATË” ka deklaruar si më poshtë:

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje	
------------------	------------------	--

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [X] Jo []	

III.1.5 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.6. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të*

nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike,

që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

4. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.1.7. Në nenin 82 pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet se:

“3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme:

a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij.

c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet.”

III.1.8. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.1.9. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar përcaktohet se: *“1. Bashkë me dorëzimin e*

kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.

III.1.10. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon: a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; 16 c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionarit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet,

nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi; l) operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi; ll) operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari 17 dorëzimin e dokumenteve provuese, të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j”, të pikës 2, të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit. Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë dokumentet provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin. Për dokumentet e ofertës, të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, ofertuesi i kualifikuar i pari duhet t’i paraqesë këto dokumente në origjinal ose të njësuar me origjinalin. Gjithashtu, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik, si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.”.

III.1.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim, ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët

Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

III.1.12. Nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorëve ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHKPK me arsyetimin se: *“...kompanitë ndodhen përballë faktit se janë të paafta të përmbushin detyrimin e tyre ligjor në lidhje me furnizimin me artikujt objekt prokurimi si dhe me kapacitetin e tyre teknik mbi trajnimin dhe kalibrimin e pajisjeve të autoritetit pasi pasi artikujt objekt prokurimi reagent/kite/pajisje matesë janë ne 98% të tyre artikujt të firmes Hanna Instruments dhe se kjo kompani prodhuese i ka dhënë ofertë vetëm kompanisë sonë ISOMETRIC, ku vërtetohet që kompania jonë është e vetmja që ka marrë një ofertë të saktë nga prodhuesi i artikujve objekt prokurimi si dhe është e trajnuar mbi kalibrimin e pajisjeve të autoritetit me reagentet/kite/pajisje objekt prokurimi. Pra të dy operatorët e kualifikuar kanë dhënë një ofertë jo të bazuar në cmime të vërteta pasi nuk kanë marrë ofertë nga prodhuesi për këto artikuj gjë që con në pamundësinë e tyre mbi furnizimin e autoritetit kontraktor me mallrat objekt prokurimi.)*, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi dhe në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve dhe kërkesave për t'u plotësuar nga ofertuesit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës objekt-prokurimi si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesat e vendosura. Në plotësimin e dokumentacionit të ofertës, operatorët ekonomikë duhet t'i përmbahen me rigorozitet dokumenteve të publikuara në DST, duke plotësuar të gjitha dokumentet siç ato janë përcaktuar nga autoriteti kontraktor si dhe të detyrueshme për t'u plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofertojnë në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, referuar pretendimeve të ankimuesit, Komisioni kreu verifikimet mbi dokumentacionin e ngarkuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik, nga operatorët ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHKPK, nga ku konstatohet se operatorët ekonomikë kanë dorëzuar si pjesë të ofertës së tij ekonomike: Shtojca 1 Formularin e ofertës ekonomike të plotësuar të firmosur dhe vulosur, si edhe Shtojca 3, Lista e Çmimeve të Artikujve, plotësuar tabela me emërtimet e të gjithë artikujve, duke listuar artikujt me sasi të kërkuara, çmimet për njësi dhe vlerat pa tvsh dhe me tvsh. Sa më sipër Komisioni konstaton se dokumentacioni sipërcituar (Pika I.4) oferta

ekonomike të operatorëve ekonomikë “Skyline SC” SHPK dhe “Albuji” SHPK rezultojnë të plota, të firmosura dhe vulosuar nga përfaqësuesit e operatorëve ekonomikë dhe nuk janë anomalisht të ulta. Refruar ankesës së operatorit ekonomik ankimues “IOSOMETRIC” SHPK Komisioni konstaton se, kemi të bëjmë me një pretendim të pambështetur në prova dhe ligj. Në asnjë pikë të Shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar asnjë kriter që të përcaktojë se oferta e operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë ofertë e bërë drejtëpërdrejtë nga prodhuesi.

Lidhur me pretendimet e ankimuesit se *të dy operatorët ndodhen përballë pamundesisë së tyre në përmbushjen e kërkesës nr. 4 ne dokumentacionin Specifikime dhe relacion teknik*, Komisioni gjykon se kemi të bëjmë me një pretendim mbi një kriter të pakërkuar. Komisioni gjykon se pretendimet e cituara në ankesës nuk janë të mbështetura mbi ndonjë kriter, pra janë pretendime për një kriter të pakërkuar. Në këtë kuptim KPP gjykon, se këto pretendime nuk qëndrojnë, pasi janë mbështetura mbi kriterë të pakërkua dhe të pa përcaktuar në Shtojcën 8 të dokumentave të tenderit. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në mënyrë eksplicite, ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit, të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, jo vetëm që është në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. KPP gjykon se në cilësinë e një organi quazi gjyqësor, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës Judicis est judicare secundum allegata et probate (organi vendos në bazë të fakteve dhe provave të administruara në proces). KPP nuk mund të gjykojë mbi plotësimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi kriterë të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e garës

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur, e Thjeshtuar - Mallra”, me nr. REF-73483-12-30-2025, me objekt “Blerje Reagent dhe Epruveta”, me fond limit 1,400,000 (Një milion e katërqind mijë) lekë pa TVSH , zhvilluar më datë 12.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Kamëz sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publikk
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

